



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2024:000947
Datë: 20.06.2024
Numri i dokumentit: 05839817

C.nr.1573/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Betim Behluli, me bashkëpunëtorin profesional Armond Qmega, në çështjen juridike kontestimore të paditëses S.K-O, nga Rahoveci të cilën e përfaqëson avokati Z.H, nga Prishtina, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,328.700 euro, jashtë seancës, me datë 20.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET POSHTË, padia e paditëses në këtë çështje juridike si e pa lejuar, për shkak të çështjes së gjykuar - Res Judicata.

II. DETYROHET paditësja S.K-O, që të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, t’ia paguajë shpenzimet procedurale në shumë prej 104,00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktvendimit.

A r s y e t i m

Paditësja S.K, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar, më datën 27.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, ka parashtruar padinë për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,328.00 euro.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, në përgjigjen në padi të datës 19.06.2024, ka theksuar se e konteston në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditësja S.K – O, me aktgjykim C.nr.754/2021, me nr. të lëndës 2021:170808, të datës 29.02.2024, është kompensuar në emër të kualifikimit / licensimit për periudhën 27.07.2018- 31.12.2022, andaj e kontestojnë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses për kompensim në emër të kualifikimit për periudhën 2021 -2022. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta hedh posht për shkak të çështjes së gjykuar (res judicata). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata ka vendosur që ta hedhë poshtë si të palejueshme kërkesëpadinë e paditëses S.K – O në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data

01.01.2021, e deri me datën 31.12.2022, pasi që ka vërtetuar faktin se me aktgjykimin e kësaj gjykate me numër C.nr.754/2021 të datës 29.02.2024, paditëses S.K – O i është njohur e drejta e kompenzimit në emër të kompensimit të diferencës së pagës për kualifikim, për periudhën kohore nga data 27.07.2018, e deri me datën 31.12.2022. Kjo gjykatë kërkesëpadinë e paditëses për kualifikim, e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika d) të LPK-së sipas të cilit parashihet që *“Pas shqyrtimit paraparak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: d) çështja është gjë e gjykuar (res iudicata)”*.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe dispozitës së lartcekur si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 al. 1 pika d., të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi. Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit dhe 452.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1573/2023, më datë 20.06.2024

Bashkëpunëtor profesional
Armond Qmega

Gjyqtari
Betim Behluli

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.